



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 1792/12 prot.

Memaliaj më 15. 08. 2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 15. 08. 2025 në sallën e këshillit kati i parë në godinën e Bashkisë Memaliaj. Këshilltarë pjesëmarrës 13 këshilltarë në momentin e fillimit të mbledhjes.

Ora e fillimit të mbledhjes 10:00.

Tema e mbledhjes: "Interpelancë me kryetarin e Bashkisë Memaliaj z. Albert Malaj".

1- Për konstatimin e mosparaqitjes të projekt vendimeve dhe materialet shoqëruese nga kryetari i bashkisë në kundërshtim me ligjin 139/2075 "Për vetëqeverisjen vendore".

2- Për shkeljen e ligjit nga kryetari i bashkisë për moszbatimin e ligjit 139/2015 neni 51 "Për vetëqeverisjen vendore".

Kryetari i Këshillit z. Erjon Sinanaj e deklaroi mbledhjen të hapur.

Jeni njohur me situatën e krijuar dhe komunikimin shkresor për muajin korrik me administratën dhe mosreagimin e saj. Nisur nga situata kryesia u mbledh dhe vendosi thirrjen e interpelancës me kryetarin e bashkisë. Siç jeni vënë në dijeni dhe për pagesën e këshilltarëve që është një shkelje nga ana e administratës si dhe tejkalim kompetencash. Me sa vë re kryetari i bashkisë nuk është prezent dhe nuk ka kthyer ndonjë përgjigje me shkrim për arsyen e mosparaqitjes në këtë mbledhje. Kam njoftim nga këshilltarët se u është dërguar një shkresë ku ankohet se nuk është bërë mbledhje. Ne u kthyem përgjigje me shkrim, pse nuk e pamë të arsyeshme si emergjente.

Ju ftoj për diskutim.

Z. Taulant Rama: Nuk kemi ç'të diskutojmë, kryetari nuk ka ardhur dhe ligji e ka të qartë, kur nuk vjen i kërkuari për interpelancë. Në respekt të këshilltarëve dhe të dinjitetit tonë njerëzor dhe si përfaqësues të komunitetit unë mendoj se duhet t'i drejtohem urgjent kryetarit të bashkisë dhe në qoftë se e do rasti t'u theksohet se janë në shkelje dhe kanë marrë kompetencat e kryetarit të këshillit, t'u theksohet e ndoshta t'u dërgohet dhe autoriteteve si prefekti i qarkut dhe ministrit të pushtetit vendor që ka një shkelje dhe mosnjohje të hapur nga ana e administratës për kunddrejt këshillit dhe të gjitha akteve normative. Ju kryetar jeni i autorizuar nga këshilli nuk mund ta tolerojmë këtë situatë është shkelje flagrante, tendencioze konflikt artificial i ngritur ndaj këshillit. Gjëja që më shqetëson

[Handwritten signatures and initials]

mua si këshilltar këto mosmarrëveshje rëndojnë në kurriz të qytetarit. Nëse s'ka një marrëveshje me administratën duhet t'i drejtohem gjykatës. Mua si këshilltar më është cenuar dinjiteti dhe nuk mund ta lejoj që moszbatimi i ligjit të na ngarkojë neve si këshilltarë.

Xhevit Kacorri: Kjo situatë është sa tragjike dhe komike. Në shkresë shoh më shumë nota personale dhe jo institucionale midis dy kryetarëve. Ju kryetar keni përdorur termin e gabuar. Ne si këshilltarë jemi gati të vijmë kurdoherë. Në raport me situatën unë mendoj të bëjmë një dalje publike që asistencë nuk është ndaluar për shkakun tonë si këshilltarë por sepse bashkia nuk ka sjellë asnjë material. E fundit unë e kam përjetuar situatën dhe ndjej një trysni nga ana e administratës për të nëpërkëmbur këshillin dhe autoritetin e këshilltarit. Jemi ne ata që mbikëqyrim punën e administratës dhe jo anasjelltas. Dua të vë në dukje dy episode të vogla nga shkresa që kryetari na ka dërguar neve si këshilltarë dhe nuk mund të na trajtojnë pa autoritet. Të kthehet bashkëpunimi me kryetarin e bashkisë, nëse ai gaboi duhet të jemi ne që të bashkëpunojmë për zbatimin e ligjit me administratën e bashkisë për të rregulluar këtë marrëdhënie të tensionuar që është krijuar.

z. Erjon Sinanaj/kryetari: Të falënderoj Xhevit dhe po e nis atje ku e le ku the se diskutimi ka kaluar personal midis kryetarit të bashkisë dhe kryetrit të këshillit, sepse te shkresa që ju është dërguar juve besoj se do të jetë përmenduar diçka e tillë. Tani në bazë të kësaj që tha Xhevit është diçka personale. Ne bëmë këtë mbledhje në muajin korrik në të cilën ju nuk morët pjesë ku nuk u paraqitën materialet e mbledhjes nga ana e administratës nuk e përjetuat dhe ju atë ndjesinë që të vish në mbledhje dhe të mos jetë administrata e pranishme. Megjithatë unë nga ana ime nuk kam asgjë personale. Ju ku e kuptuat këtë?

Xhevit Kacorri: Tek shkresa e ardhur nga kryetari i bashkisë, ju drejtohet personalisht juve dhe ka nota emocionale në lidhje me kryesinë dhe kryetarin e këshillit.

Erjon Sinanaj: Në mbyllje të fjalës suaj thatë të bëhet publike ku të sqarohet se shkeljet e administratës të mos na faturohen neve si këshill.

Xhevit Kacorri: I qëndroj fjalës që thashë prandaj kërkova të bëjmë një foto dhe bashkëngjitur një informacion mbi situatën ta shkarkojmë përgjegjësinë për moskalim të 6% sepse nuk është përgjegjësi e jona, kjo të pasqyrohet në facebook-un e këshillit që të njihen qytetarët me situatën.

Erjon Sinanaj: Përsa i përket pikës së dytë që the po mua mu pre pagesa, unë do të shkoj në gjyq.

Xh. Kacorri: Nuk mund ta lejoj administratën të më nëpërkëmb mua si këshilltar. Si e thotë ligji mbledhjet jashtë radhe bëhen për emergjencë apo bëhen kur t'i teket kryetarit të bashkisë?

Erjon Sinanaj: Po z. Xhevit këtu ke shumë të drejtë, mbledhja e kërkuar ishte për një p/vendim që ishte diskutuar në mbledhjen e muajit qershor, i cili u rrëzua me argument dhe u kërkuar ndryshime dhe erdhi pa asnjë ndryshim kështu që nuk u vlerësua as si emergjencë sepse nuk shfaqej asnjë emergjencë në atë p/vendim dhe nuk ishte pasqyruar asnjë ndryshim i kërkuar nga këshilltarët.

Esmerald Xhemali: Unë mora shkak nga dy diskutimet e kolegëve dhe i mbështes të dy mendimet dhe të Taulantit dhe të Xhevitit në lidhje me situatën e krijuar. E para unë nuk isha dakord që kjo mbledhje të vazhdonte po meqenëse vazhduam dhe t'i diskutojmë me njëri-tjetrin, pak a shumë të gjithë në të njëjtën frekuencë jemi pavarësisht se na ndajnë kahet politike këtu s'ka vend për ndarje sepse po e trajtojmë si një të tërën, se ka të bëjë me këshillin si institucion. Unë mendoj se e gjitha kjo vjen nga padija, nga mosnjohja e ligjit dhe kompetencave sepse në momentin që dikush e njeh ligjin, njeh dhe kompetencat, njeh autoritetin. Vjen nga padija se vijmë tek ajo që thotë Xhevit ka kaluar në personale, nuk ka pse të kalojë në personale sepse këshilli është institucion dhe si institucion ka dhe një hierarki. Ka një kryetar, ka dhe një kryesi dhe në një komunikim që kisha me

[Signatures]

[Signature]

Kryetarin e bashkisë, ia kujtova që kryesia është autoritet vendimmarrës, të cilën ai nuk e dinte dhe kryesia duhet të ketë dhe një përfaqësues të opozitës, që ne e kemi në vakancë e themi çdo mbledhje që do ta zgjedhim do marrin masa, sepse kryetari i bashkisë do të kishte një zë, një palë sy dhe një palë veshë në kryesi do ta kuptonte që këtë vendimmarrje nuk e bën Erjoni si kryetar, por këtë vendim e merr kryesia e këshillit dhe që këtu fillon me deficiencë kjo punë. Pra bie pjesa e personales së kryetarit të këshillit ndaj kryetarit të bashkisë. Tani vijmë te mbledhjet jashtë radhe kompetencë e kryetarit të bashkisë është vetëm të kërkojë mbledhje jashtë radhe sipas ligjit dhe rregullores përcaktohet qartë se si veprohet. Por ka një tjetër moment kur mbledhjen jashtë radhe e kërkon 1/3 e këshilltarëve dhe sekretari i këshillit e ka detyrim ligjor të njoftojë për datën dhe rendin e ditës. Kryetari i bashkisë nuk e ka bërë këtë se mund ta bënte ja tek i ka 5 këshilltarë opozitarë, pastaj bëhet korumi për zhvillimin e mbledhjes është tjetër gjë ajo dhe këtë nuk e di që ta ushtronte si opSION nëse do të ishte vërtetë emergjencë. Tani te këto mbledhjet unë kam vënë re dhe e kam shprehur dhe më herët se ushtrohet një lloj presioni, një lloj dhune se nëse rrëzohet një p/vendim sot me votë, kërkojë një ndryshim apo qoftë edhe "kapriço" si këshilltarë dhe sa mbaron kjo mbledhje, kryetari i bashkisë dërgon kërkesë për mbledhje jashtë radhe dhe është pranuar dikur nga kryesia dhe u është hapur oreksi dhe është bërë dhe një tjetër pa përmendur emra emra këshilltarësh është rrëzuar një p/vendim me argumenta, qoftë dhe idioteske, ai ta ka sjellë prapë muajin tjetër, të njëjtën gjë dhe unë e kam votuar pro herën e dytë. Tani ç'bëjnë këto? Këto na ulin neve autoritetin dhe i jep dikujt të drejtë që mendoj se çdo bëjnë këta prandaj jemi në këto ditë kështu. Që të gjitha këto e kanë një zanafillë mirë është që të ulemi dhe sot duhej të ishte këtu Kryetari i Bashkisë që të mbronte atë vendim që ka marrë qoftë dhe kapriço e tij, të na dëgjonte dhe mbase do të rivendoseshin ca ekuilibra të reja ku të ndaheshin dhe kompetencat. Kjo është kompetenca jote ushtroje, kompetencat tona mos na i nga. Pastaj për ta zgjidhur kështu me forma, jo do ta bëjmë publike e deklarata në facebook nuk jam. Xhevit Kacorri: Esenca e kësaj mbledhjeje është se çfarë sqarojmë me njëri-tjetrin, unë me pozicionin e këshilltarit jam i mendimit që të bashkëpunojmë sepse janë ndëshkuar të pafajshmit me qëndrimet tona. Mendoj se situata do sqaruar publikisht sepse nuk e mori vesh njeri se ç'u bë këtu, kurse kur i thua publikut se në mbledhjen e mëparshme kryetari i bashkisë dhe administrata nuk ka sjellë asnjë material në këshill për të kërkuar miratim dhe t'i thaush për këtë precedent është thirrur në interpelancë kryetari i bashkisë dhe s'ka ardhur në një mënyrë pastrojmë veten nga thashethemet dhe tregojmë pozicionin tonë, pse duhet ta mbajmë të fshehtë këtë punë, ne mik kemi ligjin. Arsola Muzha: Unë doja t'ua bëja të ditur kolegëve që kanë munguar herën e kaluar se ne 1 ditë para mbledhjes kishim mbledhjet e komisioneve dhe nuk na erdhi asnjë nga administrata dhe kemi kërkuar qoftë me komisionin e barazisë gjinore, qoftë me komisionin e ekonomisë që janë mbledhur kemi kërkuar që të na silleshin brenda orës 10:00 të datës 30. 07. 2025 listat e 6% dhe listat për fondet e bashkisë dhe në vend që të na vinte lista na vjen një përgjigje që neve ju kemi pritur por ju nuk keni qenë 2 orë, ku e keni bërë mbledhjen e komisionit. Kamera ka, le të hapen dhe mund të shihet fare mirë se kur kemi hyrë dhe kur kemi dalë. E kam cituar se shkresat nuk dorëzohen me shkrim dore. Shkresa duhet shkruajtur me kompjuter, në sallën e këshillit nuk ka kompjuter, kështu detyrimisht te zyra e sekretarit të këshillit do ta shkruaja. Administrata pa pikë turpi ka kthyer përgjigje se komisionet nuk janë mbledhur. Vendimet e marra nga komisionet i kam protokolluar vetë në protokoll. Kur nuk isha si e firmosa dhe e protokollova shkresën? Ta them këtë që të kuptosh tamam sepse e the që jemi ne fajtor që sillen ata "ashtu". Unë nuk e quaj fare veten fajtor z. Xhevit unë punën time e kam bërë dhe prisja të më vinte lista para fillimit të mbledhjes.

 Arqë ka bërë gabim le ta mbajë gabimin.

Xhevit Kacorri: Atëherë në mbledhjen e radhës që do të bëhet silli si fakte këto që listove.

Arsola Muzha: Më ka kthyer përgjigje që s'ke bërë mbledhje komisioni jo të më jap shpjegim pse se ka kryer detyrën administrata. ne jemi ata që kontrollojmë ata, jo ata ne. Unë e kam dërguar raportin e mbledhjes së komisionit. Është absurd fare fakti që Erjoni ka bërë mbledhjen e kryesisë dhe ka firmosur njoftimin që na ka ardhur neve, për mbledhje të cilin e kemi të gjithë dhe administrata ia pret pagën. I pritet paga kryetarit kur shkresat vërtetojnë se e ka bërë detyrën, bashkia i ka njoftimet e mbledhjes në protokoll, ç'presim ne anëtarët e këshillit.

Taulant Rama: Duke parë se ajo letra e administratës dhe pretendimet ishin vërtetë "fantastike".

Administrata në atë letër vërteton se ka probleme të theksuara të kuptimit insitucional të gjësë dhe të ligjit po e po. Tani shih çfarë ndodh janë tri momente mbledhjesh mujore, jashtë radhe, e jashtëzakonshme që u përket emergjencave dhe fatkeqësive natyrore. Në këtë rast kryetari i bashkisë kërkon mbledhje jashtë radhe tallje është kjo? Pse do thoshit? Sepse, e konsideron si të domosdoshme:

1- Nuk ka argument.

2- Ka një procedurë përmbledhjen jashtë radhe do 15 ditë pune deri në zhvillimin e saj.

3- Thotë që në mbledhje jashtë radhe kur nuk miratohet mbledhja, materiali i sjellë nga administrata futet në mbledhjen e radhës.

Bujar Mamaj: Të gjithë janë në një mendim të përbashkët që administrata ka tejkaluar kompetencat, unë dua të marrim hapat që të zgjidhim këtë problem. Masat që duhen marrë, që administrata ka gabuar kjo është e ngurtë dhe tepër e qartë.

Flamur Mushamati: Mendimi im është ta tejkalojmë këtë problem duke gjetur rrugën e bashkëpunimit me këtë ritëm edhe ne si këshill edhe ata si administratë. Në rast se do të vazhdojmë kështu e dëmshme për të dy palët. Ai koordinatori i BtF nuk ishte sot. Edhe ai do të ishte mirë të ishte sot. Esmerald Xhemali: Ideja ime në lidhje me ngërçin e krijuar, ne këtu jemi dhe në fund të muajit, sjellja ose jo e materialeve nuk është problem i këshillit, por i administratës.

Lauresha Lila: Unë jam një pjesëmarrëse shumë e rregullt e mbledhjeve të këshillit dhe e di arsyen se pse jemi në këtë gjendje them se kjo është për shkak të një mbledhjeje që ka kërkuar kryetari për dy muaj rresht si mbledhje jashtë radhe dhe nuk u është kthyer asnjë përgjigje. Janë kërkuar dy herë rresht dhe nuk i është dhënë përgjigje kryetarit.

Afize Sula: Mos merr përsipër të japësh shpjegime është mirë këtu të vijë kryetari sepse nuk mund të lozni me dinjitetin e këshilltarit.

Erjon Sinanaj: E cilit mendim jeni ju Lauresha?

Lauresha Lila: Unë jam e nendimit që të ulemi dhe të falsim sepse nuk e dijmë arsyen përse ai nuk ka ardhur sot në mbledhje.

Erjon Sinanaj: A të është kthyer ty ndonjë përgjigje se neve s'na ka kthyer njeri përgjigje?

Asqeri Muçoima: Ajo që ka bërë sot kryetari është e pafalshme.

Lauresha Lila: Ne këtu jemi për një qëllim të ndihmojmë komunitetin dhe kryetari këto punë i bën për komunitetin. Duhet të bashkëpunojmë në mënyrë korrekte nga të dy palët.

T. Rama: Ne i jemi lutur njerëzve për të kryer punët për komunitetin. Ne nuk mund të rrimë gati- tu sa herë që të duan ata.




1. Largohet nga mbledhja Lauresha Lila.

2. Largohet nga mbledhja Bujar Mamaj.

Kryetari: Mendimi i këshilltarëve është t'i drejtohem autoriteteve me shkresë për situatën e krijuar dhe zgjidhjen e këtij ngërçi të krijuar.

Mbledhja deklarohet e mbyllur nga kryetari i këshillit.

Këshilltarë pjesëmarrës:

1. Arsola Muzha 

2. Xhevit Kacorri 

3. Anest Halili 

4. Taulant Rama

5. Asqeri Muçoima 

6. Afize Sula

7. Petrit Lumani

8. Erjon Sinanaj

9. Esmerald Xhemali 

10. Flamur Mushamati

11. Maltona Bërxi 

Sekretari i Këshillit

Erjola Allka



Kryetari i Këshillit

Erjon Sinanaj

